VENDIM
Nr. 43, datë 23.1.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri "Shpenzime korente", t'i shtohet fondi prej 100 000 (njëqind mijë) USD, për t'ia dhënë qeverisë turke si ndihmë humanitare për përballimin e kostove të strehimit të refugjatëve sirianë.

2. Ekuivalenti në lek i shumës së përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha